

DEKRET

“PËR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE “VAKANCË E PARAKOHSHME””

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi vlerësova njoftimin **nr. 268 prot., datë 18.09.2020** dhe **Vendimin nr. 29, datë 16.09.2020**, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, administruar me nr. 3188 prot., datë 21.09.2020, nëpërmjet të cilit KED-ja ka vendosur njoftimin e Presidentit të Republikës për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidatave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur fillimisht nga Presidenti i Republikës me **Dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018**, rishpallur me **Dekretin nr. 11291, datë 27.09.2019**, për shkak se në përfundim të procedurave të verifikimit të ndjekura nga KED-ja, rezulton se në garë për plotësimin e këtij vendi vakant aktualisht nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë,

Dekretoj:

Neni 1

Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me qëllim plotësimin e “Vakancës së parakohshme” të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj.

Neni 2

Rishpallja e kësaj procedure aplikimi dhe publikimi i saj sipas tekstit bashkëlidhur të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. Dekretit 11742

Tiranë, më 24.09.2020

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ILIR META**